



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 107, Datë 10.07.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
PËR VITIN 2017 PËR SHOQËRINË OST SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, gërmat “a” dhe “e”; neni 60, pika 4 dhe 5; nenit 110, pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009; “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 62, datë 15.09.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2017, për shoqërinë “OST”sh.a., të përgatitur nga Drejtoritë teknike të ERE;

Konstatoi:

- Me anë të shkresave nr.774 datë. 03.11.2016 dhe nr. 275 datë 30.03.2017, ERE ka kërkuar paraqitjen për miratim të Planit të Investimeve për vitin 2017.
- OST sh.a. me anë të shkresës nr.274/1 datë. 03.03.2017, ka paraqitur në ERE tabelën e Planit të Investimeve për vitin 2017 të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës.
- Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, konstatoi që ajo nuk mund të konsiderohet kërkesë për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, në kuptimin e parashikimeve të “Rregullores për Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Licencuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr.62 dt.15.09.2009.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin Planit të Investimeve për vitin 2017 për Shoqërinë “OST”sh.a., me kusht që shoqëria të depozitojë në ERE jo më vonë se 30 ditë nga marrja e këtij vendimi, aplikimin sipas kushteve të parashikuara në “Rregullore për

Procedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Licencuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike”

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI